



DE-FEST

"TOURNEE" FESTIVALS FIER
LABORATORIES & THEATER PRODUCTIONS



Interreg - IPA CBC
Italy - Albania - Montenegro



TOURNEE

MINISTERO DELLA CULTURA

MINISTRI ERI I KULTURËS

MINISTARSTVO KULTURE

MINISTARSTVO KULTURE



TEATRI "BYLIS,, SHFAQ:

KENGETARJA TULLACE

ANTIKOMEDI NGA EUGENE IONESCO

Regjisor
SPIRO DUNI

ME
FATMIR XHELILI
MIORA SITAJ
ASTRIT HASANI
FLAURA KURETA
MARGENT ÇAUSHI
DORIANA CAUSHI

SKENOGRAF & KOSTUMOGRAF
GEZIM HAJDINI
ILIRIAN SADIKU
AS.REGJISOR
DORIANA CAUSHI
FORMULIMI MUZIKOR
FREDI TASE

Interreg - IPA CBC
Italy - Albanis - Montenegro
TOURNEE



"Këngëtarja tullace" është një vepër e teatrit absurd (Eugene Ionesco), një vepër për çdo kohë, pasqyrë e falimentit moral dhe mendor të shoqërisë njerëzore.

Njëkohësisht pasqyrimi i një bote njerëzish që gjenden në udhëkryq, sepse nuk mund të komunikojnë më as me veten.... Vlerat janë kthyer në antivlera, gjuha nuk është më një mjet komunikimi, por mjet gënjeshtre dhe mashtrimi. Fjalët janë kthyer në lëvizhga tingujsh pa kuptim, brenda një bote që ka humbur identitetin, që ka humbur çdo gjë njerëzore, ku njerëzit pa ndjenja tashmë, nuk kanë më arsye të komunikojnë.

Humori i jashtëzakonshëm i Ionescos shkon në ekstrem....

"Aty thotë një kritik, një rrëshkitje dhe arrijmë ne tragjizëm"... Në vepër gjërat më të panatyrshme kthehen në të natyrshme. Njerëzit duket sikur nuk mund të mendojnë më, por ç'rëndësi ka kjo thjesht ata rrotullohen në kohë dhe hapësirë, ku në të vërtetë s'ka as kohë dhe as hapësirë për këta personazhe të "lumtur" në dukje (mjerane). Humori tepër "therës" i Ionescos e bën realitetin të duket i çuditshëm, paradoksi del në sipërfaqe, absurditeti i jetës njerëzore përballet me ne dhe ne shtangemi me maskën e çudisë së dhimbshme. Teatri i absurdit rishikon fatin e njeriut, rishikon egzistencën tonë...

Spiro Duni



L' ORCHESTRA MAGNA GRECIA RACCONTA GLI ORI

UN CONCERTO PER LA PACE

Erika Liuzzi - soprano | **Roberto Cervellera** - tenore
Armando Kllogjari - tenore | **Piero Romano** - direttore
Orchestra della Magna Grecia


Programma:

- E. Di Capua** - 'O sole mio
G. Donizetti - So Anchi 'io la virtù magica, da "Don Pasquale"
S. Falcone - *Mysteria* "Stanze musicali" (testi di Claudia Lucia Ostuni)
P. Jakova - Margjelo
F. Lehar - Tace il labbro, da "La vedova allegra"
G. Puccini - E lucean le stelle, da "Tosca"
G. Puccini - Vissi d'arte, da "Tosca"
G. Turco - Funiculi Funicula
G. Verdi - Brindisi, da "Traviata"
G. Verdi - Merce dilette amiche, da "Vesperi Siciliani"

2 0 1 9

18/09	19/09	20/09	21/09
ULCINJE (Montenegro)	TIRANA (Albania)	FIER (Albania)	ARTA (Grecia)
Palazzo Cultura ore 19.00	Cattedrale ore 19.00	Anfiteatro Greco ore 19.00	Teatro Museo Arch. ore 18.00

www.orchestramagnagrecia.it



NJË TRIPTIK PËR PAQEN

"Një koncert për paqen" - një paraqitje e artit europian. Marrin pjesë artistët më të mirë të vendit dhe të huaj.

Me emra të tillë, si: *Erika Liuzzi* - soprano, *Roberto Cervellera* - tenor, *Armando Kllogjari* - tenor dhe *Piero Romano* - drejtor, orkestra "Magna Grecia" do të sjellë një repertor të pasur, me pjesë nga kryevepra të njohura botërore.

Programi, i cili do të shtrihet në disa qytete të Malit të Zi, Shqipërisë dhe Greqisë, do të ketë një përmbajtje të larmishme me pjesë nga Verdi, Puccini, Falcone, Di Capua etj.

"Një koncert për paqen" ka si qëllim bashkimin e popujve dhe kulturave të ndryshme, si një koncept unik i paqes universale.



FARSA E KUORORËS

Autor
Arben ILIAZI

Regjisor
Ledian GJEÇI

Drejtuës Artistik
Milto KUTALI

Interpretojnë


Erion HINAJ
Dajana NENAJ
Xhuliano BRISKU

Skenograf & kostumograf Gazment KOÇOLLARI

Sot vetëm budallenjtë dhe të marrët mund të jenë të lumtur. Jemi shoqëria e homo stupidus. Jetojmë në një shoqëri të dominuar nga frustrimet, ku ndjesia mbizotëruese është ajo e ndodhjes në një mjedis ku ndjehesh i përjashtuar, i pasigurtë.

Frustrimi më pas shndërrohet në zemërim, që të çon tek dëshira për të grapur e shqyer gjithçka dhe për të ikur nga sytë këmbët. "Farsa e Kurorës" reflekton kështu mbi bashkëkohësinë dhe mbi njeriun e sotëm shqiptar. Jetojmë në një kohë kur njeriu nuk është më i lirë të zgjedhë, por ka vetëm opsionin e bekuar të mërgimit.

Familjet e sotme shqiptare përjetojnë apokalipse shumë të shpeshta, të cilat dikur as që merreshin me mend. Është vlarë shpresa dhe besimi te familja dhe shoqëria dhe ka shpërthyer individualizmi dhe frika nga e ardhmja. Të gjithë mendojnë për veten. Komedia "Farsa e Martesës" është një fabul tepër e prekshme për të kuptuar se qëniet njerëzore dhe marrëdhëniet mes tyre janë më komplekse dhe interesante se sa duken.



ERDHI GODOJA

DANIEL CURZON
REGJIA: SHKELZEN BERISHA



SKENOGRAPHI DHE KOSTUMET: DENIM KORÇI

INSPIKENTI: RYF HAZRA
FORMULIMI MUZIKOR: FLORIM GJERÇA
DITIMI: FATMIR HALLI
REKUZITIMI: SHKELZEN BERISHA
GARDEROBIERE: DIJAKRE KURTILIMI
REALIZATORË TË SKENOGRAPISË: MEDA HODI
HANI ALI FEJMI HODI

LUANË:

AVNI SHKODRA
GANI RRAHMANI
TRINGA HASANI
MOMÉZA KALAVESHI

SPECIAL GUEST OF DE/FEST APOLONIA 2019
(OUTSIDE TOURNEE PROJECT CALENDARI)



Mu aty ku përfundon vepra e famshme e Samuel Beckett "Duke Pritur Godonë", fillon komedia e absurdit "Erdhi Godoja", e cila edhe e sjellë pikërisht Godonë.

Ardhja e tij shkrep përmbajtjen duke çuar në situata të ngërthyera mes komikes dhe absurdit, por që burojnë kontekste që i ndeshim në jetët tona çdo ditë.

Me ardhjen e Godosë, dy njerëzit, të cilët me parë ishin të paaftë për të vepruar, lëvizin a mendojnë pa ndihmën e dikujt tjetër, hidhen në një rrugëtim për të gjetur përgjigjet e shumë pikepyetjeve shpirtërore, materiale e intelektuale, ndërkohë që neve na japin një pamje të përthellë brenda dualitetit të natyrës njerëzore.

Gjithsesi, kjo përvojë vlen që dy "pritesit" të pandehin se ndoshta vet akti i pritjes është domethënës në vetvete edhe pa përjetuar ardhjen e shpëtimtarit.



L'ISOLA

ADDE: PHOTOGRAPHY/VINCENZO DE PIRTO



TESTO E REGIA
FRANCESCO TAMMACCO

CLAUDIA CASTRIOTTA, MARCO SALLUSTIO, LEONARDO MEZZINA, GEMMA AMATO, CLAUDIA GDALETA, ANNA ELY NAPPI,
CARLO SALVEMINI, PASQUALE SALVEMINI, MARTINA CIANNAMEA, VALENTINA DE CANDIA, ARIANNA ORVIETO,
GIOVANNA GUARINO, PIERLUIGI DE PALMA, DOMENICO ESPOSITO, ANNA PAOLA RACNO,
NICOLE TURTUR, MARIANTONETTA MAGGIO.

CONDIRETTORE
BENEDETTA LUSITO

TRAMPOLLINO
NIKY GIANCASPRO

ALLESTIMENTO SCENICO
MATTED ALTOMARE

UFFICIO ORGANIZZATIVO
MARIA GIOVANNA DE BIASE
TEL. 349 23 80 823

Ishulli

Shfaqja është frymëzuar nga historia, e shkruar dhe ilustruar nga Armin Greder:

“Ishulli është një histori e çdo ditë”. Është një histori që flet për personalitetin dhe diversitetin.

Një histori e tmerrshme, një grusht në stomak; e pamundur të qëndrosh indiferent, e pamundur të mos marrësh anën e atij që është i braktisur dhe i varfër, po aq e pamundur për të mos kapur ndonjë asonancë me zemërimin dhe frikën e banorëve të ishullit.

Ndonjëri prej nesh ndonjëherë mund të ndjehet i braktisur ose i pëfshire. Askush nuk e është i përjashtuar. Sepse jeta ndonjëherë mund të sjellë më të keqen në natyrën njerëzore.



GENCI FUGA

KRISTIAN KOROVESHI

Edward Albee

HISTORIA E KOPSHTIT ZOOLOGJIK

përktheu Taulanda Jupi

skena dhe kostumet Manjola Mesareja

regjia Eni Jani

SPECIAL GUEST OF DE/FEST APOLONIA 2019
(OUTSIDE TOURNEE PROJECT CALENDARI)



"Zoo Story" është një vepër dramatike, shkruar nga Eduard Allbe, rreth viteve 1958. Eduard Allbe është fitues i shumë çmimeve, Pulitzer dhe Tony Awards, për pjesët e tij dramatike!

Kjo vepër është simboli i përpjekjes njerëzore të komunikimit, apo mungesës së komunikimit mes tyre, ndërmjet të gjitha niveleve sociale e shtresave shoqërore.

Historia është e thjeshtë: dy njerëz që takohen rastësisht në park dhe përfundojnë me (vet) sakrifikimin e njërit prej tyre. Kjo histori thekson aspektin më të vështirë të shoqërisë moderne.

Në fakt, në rast se flasim tani për Histori të Njerëzimit, nuk bëhet fjalë për gjë tjetër, përveç, historisë së mungesës të komunikimit njerëzor.

Ajo çfarë shpalolet para spektatorit janë fatet e rastësishme që kryqëzohen dhe kanë si qëllim të sfidojnë njëri-tjetrin. Kjo na ndodh përditë! Ne sfidohemi në çdo hap të jetës, duke nënvizuar faktin e mbijetesës së qenies sonë.

Pas një historie të tërë të njerëzimit, neve, ende na duhet t'i besojmë më shumë instiktit, ndryshe mund të përfundojmë "të vdekur" (fizikisht ose jo)... Duhet të kemi parasysh, që jemi "gjitarët e vetëm Predator" që "vrasim" apo "mbysim" jo për t'u ushqyer .





YASMINA REZA



ART

SILVIO GOSKOVA

BLENDI ARIFI

KRIKS DUMO

REGJIA: KRIKS DUMO
AS. REGJISORI:
ELEONORA BEZATI

PËR MË SHUMË INFORMACION
WWW.TEATRIMETROPOL.AL
+355 67 227 0668



Interreg-IPA CBC
Italy - Albania - Montenegro
TOURNEE



ART

ART sjell pikëpyetje të shumta rreth artit dhe shoqërisë në të cilën ne jetojmë, si përfaqësues të së cilës janë tre shokët: Serzhi, Marku dhe Ivani.

“Art” është shfaqur për herë të parë në vitin 1994 në “Comédie des Champs-Élysées” në Paris.

E përkthyer dhe e adaptuar në gjuhën angleze nga Christopher Hampton është shfaqur në “London West End” në vitin 1996.

“Art” është luajtur në “Broadway” dhe është nominuar për “Tony Award” për aktorin më të mirë. Gjithashtu ka fituar çmimin “Tony” si shfaqja më e mirë, duke u shpallur gjithashtu si shfaqjet më të luajtura në po këtë teatër.



KONFERENCA
IPESHKVNORE
E SHQIPËRISË



INSTITUTI
PËR STUDIMET
PËR NJËKURVË
POLITIKE



ARBEN DERI-NJEMI



AT ZEF PLLUMI

RRINO PËR MË TREGUE

Falenderojmë:
Bujar Leskaj
Eli Rrugia

Perzgjodhi tekstin:
Bashkim Hoxha

Regjisor: Milto Kutali

Skenografia: Beqo Nanaj
Muzika: Mark Luli
Graphic Design: Lorenc Buzi
As/Regjisor: Klajdi Zeqo

SPECIAL GUEST OF DE/FEST APOLONIA 2019
(OUTSIDE TOURNEE PROJECT CALENDAR)



Një vepër jo e shkruar por e përjetuar, me shumë dritë në errësirën e madhe që mbillte komunizmi. Një përshpirtje, një akt moral e njëherazi edhe një refleksion universal ndaj perandorisë komuniste.

Jeta e një të burgosuri dhe raportet e tij, më së pakti, me xhelatët, më së shumti me qeniet e gjalla jonjerëzore (një lule, një zog i vogël, një pulë që ilegalisht kishte hyrë në burg, një maçok e më pas gjithë shpresa e lirisë që kurrë nuk e lëshon njeriun).

Përfundimisht, triumfi i lirisë, kurorëzimi i përjetësisë së vuajtjeve në një libër madhor, e më pas vlerësimi i ndoshta, gjeniut më të madh të botës moderne shqiptare, Ismail Kadaresë: "Gjithë shoqëria shqiptare, ka nevojë për këtë vepër.

Kanë nevojë për të, ata që e kanë jetuar atë kohë e po aq, në mos më tepër, ata që s'e kanë jetuar. Kanë nevojë të shtypurit e të nëpërkëmburit, e po aq, në mos më tepër, ata që shtypën të tjerët.

Kanë nevojë antikomunistët, e po aq, ndoshta më tepër, komunistët. Shkurt për të, ka nevojë ndërgjegjja jonë".





TOURNEE

THEATERS FOR TOURISM DEVELOPMENT IN EUROPE
IN CO-PRODUCTION WITH
OPEROSA MONTENEGRO OPERA FESTIVAL

Presents

La Serva Padrona

Opera by Giovanni Paisiello

tournee.italy-albania-montenegro.eu



La Serva Padrona

“La Serva Padrona” është opera komike italiane (operosa), ideale për audiencën e re sepse është argëtuese, dinamike, e shpejtë dhe me humor, tipike për operën intermezzo.

Vetë ndarja e këndimit dhe aktrimit përbëhet nga një soprano, një bas bariton dhe një aktor i cili është memec dhe roli i tij në shfaqje, është nëpërmjet pantomimit dhe lëvizjeve.


“Operosa luan një rol të dyfishtë: mbase më e rëndësishme se shfaqjet që zhvillon është puna që ajo bën për trajnimin e artistëve të rinj”.

Jeremy Pound

“Rossini, Salmieri dhe kompozitorë të tillë e kanë lëvruar këtë, në fund të fundit, një mbrëmje të kënaqshme dhe shumë argëtuese.

Operosa ka qëllime të denja, i kushtohet këngëtarëve të saj të rinj dhe i ka gjetur vetes mjaft mirë një vend për të vazhduar përpjekjet e saj.”

Robert Thickness





Interreg - IPA CBC 
Italy - Albania - Montenegro
TOURNEE



REGIONE
TOSCANA



COMUNE DI
LIVORNO



COMUNE DI
LIVORNO



COMUNE DI
LIVORNO



COMUNE DI
LIVORNO